



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.212, datë 25.04.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONIN
E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 245
DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË
KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidates znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 245, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.*

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm., afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 25.05.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 14.06.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Me Vendimin nr. 57, datë 07.02.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023”, Këshilli ka vendosur:

“1. fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 7.Për kandidatën znj. {...} - relator z. Alban Toro.

5. Më datë 08.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

9. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023 përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

10. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

10.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

10.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. (tani Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (tani Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat), informacioni iu kërkuar të dyjave këtyre gjykatave informacioni i kërkuar është përcjellë në postën elektronike siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

11. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

12. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

13. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023.

14. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012, ndërkohë që ajo është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 10.11.2011 deri më 23.01.2014, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (*tani Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat*) vlen të theksohet se më datë 15.03.2022 ajo është zgjedhur zëvendëskryetare e kësaj gjykate. Më pas, me vendim nr. 518, datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

15. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 28.06.2003 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekret nr. 7155, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 8462, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, datë 15.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si Zv/Kryetare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Me vendim nr. 518, datë 05.10.2023 të Këshillit të

Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magistratit është 12 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

16. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

17. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës civile prej më shumë se 5 vjetësh.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas urdhrave për ndarjen e gjyqtarëve në dhomë/seksione dhe trupa gjykues për vitet 2014 - 2023, rezulton se:

- Për vitin 2014 ka gjykuar në total 342 çështje, 79 çështje penale , 115 çështje Civile , 72 kërkesa penale, 76 kërkesa civile;

- Për vitin 2015 ka gjykuar në total 448 çështje, 77 çështje penale , 164 çështje Civile , 102 kërkesa penale, 105 kërkesa civile;

- Për vitin 2016 ka gjykuar në total 427 çështje, 79 çështje penale, 181 çështje Civile , 97 kërkesa penale, 70 kërkesa civile;

- Për vitin 2017 ka gjykuar në total 432 çështje, 73 çështje penale, 137 çështje Civile , 86 kërkesa penale, 136 kërkesa civile;

Për vitin 2018 ka gjykuar në total 446 çështje, 56 çështje penale, 128 çështje Civile , 187 kërkesa penale, 75 kërkesa civile;

Për vitin 2019 ka gjykuar në total 623 çështje, 87 çështje penale, 240 çështje Civile , 230 kërkesa penale, 66 kërkesa civile;

Për vitin 2020 ka gjykuar në total 518 çështje, 46 çështje penale, 176 çështje Civile , 230 kërkesa penale, 66 kërkesa civile;

Për vitin 2021 ka gjykuar në total 654 çështje, 74 çështje penale, 246 çështje Civile , 188 kërkesa penale, 146 kërkesa civile;

Për vitin 2022 ka gjykuar në total 717 çështje, 90 çështje penale, 260 çështje Civile , 201 kërkesa penale, 164 kërkesa civile;

Për vitin 2023 ka gjykuar në total 343 çështje, 41 çështje penale, 119 çështje civile, 103 kërkesa penale, 80 kërkesa civile. Në 6 çështje penale dhe 5 çështje civile ka qene anëtare trupi gjykues. (Totali gjithsej 354 çështje)

- Urdhër nr. 93 datë 04.11.2013 “Shkrirjen e dhomave civile dhe penale”

- Me Urdhër nr. 25 datë 31.01.2014, Urdhër nr. 80 datë 17.04.2014, Urdhër nr. 5 datë 12.01.2015, Urdhër nr. 3 datë 04.01.2017, Urdhër nr. 3 datë 04.01.2018, “Mbi ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues”, kandidatja është caktuar të gjykojë në disa trupa gjykues në periudha të ndryshme;

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se në vitin 2011, është caktuar të kryejë stazhin profesional (1vit), ku gjatë këtij stazhi gjyqtarja ka gjykuar të gjitha çështjet, si civile, administrative familjare dhe penale. Me vendimin nr. 518, datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Këshilli i Gjykatës ka vendosur që gjyqtarja të gjykojë në seksionin civil/tregtar sipas urdhrave nr. 263 datë 16.10.2023 dhe vendimit nr.97 datë 27.03.2024. Për periudhën 05.10.2023 deri 19.04.2024 ka gjykuar në total 416 çështje.

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

21. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

22. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimin të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

23. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 23.02.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

24. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

25. Sa sipër, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet se për kandidaten znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

26. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

27. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr.245 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

28. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 23.02.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

29. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

30. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

31. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 245 datë 24.05.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile,

Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

32. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për s’kualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 245, datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimit të Këshillit nr. 245 datë 24.05.2023.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR